

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Agro & Social Fund sh.p.k., Institucion Mikrofinanciar i Licensuar nga Banka e Shqipërisë, kërkon të punësojë:

OFICER KREDIE PËR ZYRËN LAÇ

Agro & Social Fund sh.p.k. ofron kredi për biznesin e vogël dhe të vetëpunësuarit në zonat rurale dhe gjysmë-urbane ku ka hapur degë të saj. **Agro & Social Fund sh.p.k.** synon që të sigurojë kredi të cilat përmirësojnë jetën e të varfërve, krijojnë mundësi punësimi dhe nxisin zhvillimin e ekonomisë lokale.

PËRGJEGJËSITË KRYESORE TË POZICIONIT:

- Të zhvillojë portofolin e klientëve nëpërmjet aktivitetit të kredidhënies
- Të prezantojë produktet e kompanisë duke bërë marketing të drejtpërdrejtë në terren
- Të shqyrtojë nevojat dhe kërkesat për financime të klientëve duke ofruar zgjidhje në përputhje me kushtet e kompanisë
- Të sigurojë të gjithë informacionin mbi situatën financiare të klientit, duke garantuar integritetin e të dhënave mbi klientët
- Të bëjë vlerësimin e kapacitetit pagues të klientit dhe riskut të financimit, bazuar në politikat e kreditimit të institucionit
- Të ndërtojë marrëdhënie besueshmërie dhe afatgjata me klientët dhe komunitetet
- Të monitorojë rregullisht klientët pas marrjes së kredisë duke i vizituar drejtpërdrejtë në biznes/familje
- Të sigurojë një cilësi të lartë të menaxhimit të rasteve në vonesë.

KËRKESAT E PUNËS DHE KUALIFIKIME:

- Të ketë të paktën një vit eksperiencë pune në këtë profil ose në punë të ngjashme
- Të ketë aftësi shumë të mira komunikuese
- Të jetë i orientuar ndaj arritjes së objektivave
- Të jetë person i vetëmotivuar, dinamik dhe që i pëlqen të punojë në terren
- Të ketë aftësi negociuese
- Të jetë i aftë të ndërtojë marrëdhënie të besueshme me njerëzit
- Të ketë një kuptim të mirë të shërbimit ndaj klientit
- Të jetë i aftë të bëjë analizë financiare për aktivitete të ndryshme biznesi
- Të dijë të përdorë mirë kompjuterin
- Të ketë aftësi të mira në organizimin dhe vetëmenaxhimin e punës
- Licenca e drejtimit të automjetit është e domosdoshme

Aplikantët e interesuar duhet të dorëzojnë: **Kopje të CV-së & Letër interesi**

Data e mbylljes së aplikimeve është: **22 Nëntor, 2017 ora 17:00**

Vetëm aplikantët e përzgjedhur do të kontaktohen

Aplikimet është e preferueshme të dërgohen në adresën email: **burimenjerezore@asfund.org**
ose në

Agro & Social Fund sh.p.k - Tiranë

Rr: "Pjetër Bogdani", Pallati nr.23/4, Kati i II-të, Tiranë